

AKT THEMELIMI
I shoqërisë tregtare “3G-SUN” SH.P. K

Sot me date 13 / 03 / 2023, në bazë e për zbatim të Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare dhe Tregtaret” si dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë me vullnetin tonë të lirë, NE:

1. Shoqëria **“Pelikan” Sh.p. k**, person juridik shqiptar i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT-i, “J61825529G” e përfaqësuar nga Administratori Ligjor i Shoqërisë **Z. Genc MATAJ**, i biri i Feruzit, me datëlindje 07.05.1959 lindur në Durrës dhe banues në Durrës, mbajtës i letërnjoftimit nr. 027651333, madhor, dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Shoqëria **“The Best Construction” Sh.p. k**, person juridik shqiptar i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT-i, “K41510019W” e përfaqësuar nga Administratori Ligjor i Shoqërisë **Z. Agim XHELILAJ**, i biri i Hamdiut i datëlindjes 22.06.1964 lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, madhor dhe i aftë për të kryer veprime juridike i identifikuar me nr. Passp. BG8446274 dhe Nr. Personal G40622110G.
3. Shoqëria **“Vëllezërit Hysa” Sh.p. k**, person juridik shqiptar i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT-i, “K12911201C” e përfaqësuar nga Administratori Ligjor i Shoqërisë: **Z. Besnik HYSA**, i biri i Ali, me datëlindje 08.04.1973, lindur në Kamunah, Elbasan dhe banues në Klos, Elbasan, madhor dhe i aftë për të kryer veprime juridike me nr. kartë id. 034107488 lëshuar më dt.05.04.2019 dhe nr. Personal H30408015R.

Krijmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“3G-SUN” SH.P. K** me akt themelimi si vijon:

Neni 1
Formulimi

Formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur **“3G-SUN” Sh.p.k**. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Neni 2
Humbjet

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i përballon humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kapitalit themeltar.

Neni 3
Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagjja 3, Rruga Egnatia, Kulla "Fly", Kati 13, Kutia postare 2001 Durrës, Shqipëri.

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin gjatë aktivitetit të saj.

Shoqëria do të ketë edhe adresën elektronike të komunikimit; 3gsunfotovoltaike@gmail.com

Neni 4
Objekti i Veprimtarisë



Shoqëria ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj ndërtimin, menaxhimin, prodhimin, transmetimin e shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga një burimi i ri gjenerues i energjisë elektrike me sistem fotovoltaiik.

Neni 5 Kohëzgjatja e Shoqërisë

Shoqëria ka si kohëzgjatje të veprimtarisë së saj, një afat të pacaktuar. Kjo kohëzgjatje mund të ndryshohet nga asambleja e ortakëve sipas përcaktimeve të statutit dhe ligjit për shoqëritë tregëtare.

Neni 6 Kapitali I Shoqërisë

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) Lekë. Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 3 pjesë (kuota), 2 pjesë (kuota) me vlerë nominale 33.000 (tridhjetë e tre mijë) Lekë secila dhe 1 pjesë (kuotë) me vlerë nominale 34.000 (tridhjetë e katër mijë) Lekë.

Kuotat do të zotërohen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:

- | | | |
|----|--|--|
| a. | Shoqëria “Pelikan” Sh.p. k” | zotërues i 34 % të kapitalit të Shoqërisë. |
| b. | Shoqëria “Vëllezërit Hysa” Sh.p. k, | zotërues i 33 % të kapitalit të Shoqërisë. |
| c. | Shoqëria “The Best Construction” Sh.p. k | zotërues i 33 % të kapitalit të Shoqërisë. |

Neni 7

Kapitali themeltar mund të shtohet ose zvogëlohet vetëm me vendim unanim të asamblese të ortakëve. Shtimi apo zvogëlimi i kapitalit themeltar do të bëhet në varësi të rezultateve ekonomike e në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi.

Neni 8


- **Zmadhimi i kapitalit** të Shoqërisë mund të kryhet nëpërmjet shtesës së kapitalit themeltar me kontribut në para ose/dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar e licensuar sipas legjislacionit në fuqi. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë.
- **Zvogëlimi i kapitalit** lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9 Transferimi kuotave

Kuotat e kapitalit të kësaj shoqërie e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë.
- b) shitblerjes.



- c) trashëgimisë.
- d) dhurimit.
- e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, dhe të tretëve sic do të parashikohet ndryshe në statut. Në çdo rast tjetër të transferimit të pjesëve të kapitalit jashtë strukturës të ortakërisë, ortakët gëzojnë të drejtën e parablerjes.

Neni 10 Organet e shoqërisë

Shoqëria ka si organe të saj:

- a) Asamblenë e përgjithshme.
- b) Administratorin.

Renditja e mësipërme shpreh dhe hierarkinë e organeve drejtuese të shoqërisë.

Neni 11

Administratorë i parë i shoqërisë do jetë **Z. Gentjan JAHJA** me afat 2 (dy) vjecar duke filluar nga data ___/___/2023 deri me datën ___/___/2025

Adresa e administratorit është adresa e selisë së shoqërisë

Phone: Tel.+ 355 52 224017 / 225510.

Mob.+ 355 6820 91880 / 6920 89073.

Fax.+ 355 52 225511

Email. info@pelikantransport.com

Detyrat dhe kompetenca e administratorit do të përcaktohet të detajuara në statutin e shoqërisë.

Neni 13

Të ardhurat neto të shoqërisë I takojnë ortakëve të shoqërisë

Neni 14

Ortakët themelues kanë të drejtë të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale. Kanë të drejtë të caktojnë financiarë, likuidator për problemet e shoqërisë.


Neni 15

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 16

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin dhe Niptin pjesë të saj.

Neni 17 Shkrirja



Shoqëria mbaron me të përfunduar afati i parashikuar nga ky akt ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, me anë të një vendimi të asamblesë së përgjithshme dhe/ose për shkak të falimentimi.

Neni 18 Likujdimi

Në rast përfundimi, shoqëria do të nënshtrohet procedurave të likujdimit. Për të administruar këtë procedure, asambleja e përgjithshme e ortakëve emëron një ose disa likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjëndjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likujdimin.

Neni 19

Shoqëria mund të mbarojë edhe me anë të riorganizimit, nëpërmjet formave të thithjes ose të bashkimit sipas përcaktimeve të legjislcionit në fuqi

Neni 20

Akti I themelimit u perpilua në 4 kopje të njëjta, në përmbajtje e fuqi ligjore, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "3G-SUN" SH.P.K.

Akti I themelimit është hartuar në katër kopje origjinale dhe nënshkruhet rregullisht, pa vërejtje në sejcilën faqe nga ortakët themelues.

"3G-SUN" SH.P.K ORTAKËT THEMELUES

"Pelikan" Sh.p.k

Genc MATAJ




"The Best Construction" Sh.p.k

Agim XHELILAJ





"Vëllezërit Hysa" Sh.p.k

Besnik HYSA




Flutura HYSA



Kujtim HYSA

